

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

“PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE DHE KRITEREVE TË NDARJES DHE TË PËRDORIMIT TË FONDIT TË KUSHTËZUAR TË BUXHETIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN CIVILE”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektakti është miratimi i procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit të destinuar për qeverisjen vendore për mbrojtjen civile.

Sipas nenit 65, të ligjit nr. 45/2019, bashkitë, për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitetë dhe mbrojtjen civile, si dhe kryerjen e detyrave në zbatim të këtij ligji, mbështeten në parashikimin minimal prej 4 për qind të totalit të buxhetit të tyre vjetor, të cilat sigurohen nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analistik të Projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, për vitin 2021, për Ministrinë e Mbrojtjes.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Me miratimin e ligjit 45/2019, mbrojtja civile është kthyer në një prioritet për të gjithë organet e administratës publike. Ky ligj ka ndarë përgjegjësitë për këtë fushë në të gjithë nivelet si vertikale, ashtu edhe horizontale të administratës publike në shtetit tonë. Një faktor i rëndësishëm në mbrojtjen civile janë organet e vetëqeverisjes vendore, si baza e konstatimit të nevojave të komunitetit dhe si organe në paravijën e reagimit të shpejtë ndaj tyre, në rastin e një situate emergjente.

Një nga problematikat e hasura gjatë viteve është përdorimi jo i efektshëm i buxhetit të këtyre organeve, si dhe në pamjaftueshmërinë e fondeve për përballimin e pasojave të ardhura nga fatkeqësitetë e ndryshme. Gjithashtu, kemi pasur një nivel të ulët të investimeve edhe në fushat e

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”.

parandalimit dhe rehabilitimit të zonave të dëmtuara, për të evituar përsëritje të situatave të emergjencës civile.

Ky projektvendim do të zgjidhë problematikat e buxhetit të bashkive të dedikuar për mbrojtjen civile dhe reduktimin e riskut nga fatkeqësitet. Në zbatim të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, fondi i dedikuar për mbrojtjen civile do t’u kalojë bashkive në formën e një fondi të kushtëzuar nga buxheti i shtetit, në masën e 4 % të totalit të buxhetit vjetor të tyre. Miratimi i kësaj VKM-je do të ndihmojë në zgjidhjen e shumë problematikave, duke i lënë hapësirë bashkive të veprojnë dhe të marrin të gjitha masat e duhura, në kuadër të reduktimit të riskut nga fatkeqësitet dhe mbrojtjes civile.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Hartimi i këtij projektvendimi bëhet në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 65, të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”.

Projektvendimi është në përputhje me legjislacionin vendas dhe atë ndërkombëtar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektvendim nuk është përafshuar me *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKIT

Në zbatim të ligjit nr. 45/2019, u hartua urdhri i Kryeministrit nr. 148, datë 5.11.2020, për ngritjen e një grapi pune ndërinstitucional për hartimin e një projektvendimi për procedurat dhe kriteret e ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile.

Në zbatim të nenit 65, të ligjit nr. 45/2019, bashkitë, për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitet dhe mbrojtjen civile, si dhe kryerjen e detyrave në zbatim të këtij ligji, mbështeten në parashikimin minimal prej 4 për qind të totalit të buxhetit të tyre vjetor, të cilat sigurohen nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit.

Ndërkohë, bashkitë mund të planifikojnë fonde të tjera shtesë, përvèç atyre të rregulluara nga ky projektvendim, nga burimet financiare, si më poshtë:

- a) nga të ardhurat e veta vendore;

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”.

- b) nga fondet që u vijnë drejtpërdrejt nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacionet;
- c) si dhe burime të tjera të parashikuara në ligj.

Për sa i përket përbajtjes së projektaktit shkurtimisht i referohemi, më poshtë:

- Neni 1 riformulon edhe njëherë qëllimin kryesor të kësaj VKM-je, ku bashkitë për përbushjen e detyrimeve, në kuadër të reduktimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjes civile, do të përfitojnë nga buxheti qendror, **një fond të kushtëzuar**.
- Në nenin 2, ky fond i kushtëzuar që nuk do të përdoret në vitin përkatës buxhetor, nuk do të trashëgohet në vitin tjetër buxhetor..
- Në nenin 3 kemi vendosur disa prej dokumenteve kryesore që mund të përbëjnë edhe kriteret e përgjithshme të përdorimit dhe ndarjes së këtij fondi të dedikuar për mbrojtjen civile. Dokumentet strategjike janë:
 - a) Strategjinë lokale për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë;
 - b) Vlerësimin lokal të riskut;
 - c) Planin lokal të emergjencave civile;
 - ç) Planin e zhvillimit urban.

Theksojmë se këto dokumente nuk janë hartuar ende nga bashkitë, por në zbatim të ligjit nr. 45/2019, hartimi dhe përditësimi i tyre janë detyrim i këtyre organeve.

Dokumentet përcaktojnë objektivat e çdo bashkie për mbrojtjen civile, kapacitetet dhe mundësitet e ndërhyrjes. Gjithashtu, në dokumentin e vlerësimit të riskut, do të bëhet një studim shkencor i të dhënave, duke përcaktuar zonat më me risk, hartat e riskut dhe do të përcaktojë dhe nevojat për ndërhyrje në këto bashki.

Në nenin 4 kemi përcaktuar disa prej mënyrave se si mund të përdoret ky fond i kushtëzuar lidhur dhe me detyrat e përcaktuara në ligjin 45/2019 për bashkitë. Përdorimi i këtij fondi është ndarë në 3 kategori, duke marrë për bazë rëndësinë e tyre.

Fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile do të përdoret sipas prioritizimit, si më poshtë:

4/1. 60 % - 100 % e fondit të dedikuar për mbrojtjen civile mund të përdoret për:

- a) akordimin e ndihmës financiare për familjet, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga një fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera, sipas kritereve specifike të përcaktuara në aktet nënligjore që rregullojnë ligjin 45/2019, neni 41;

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”.

- b) marrjen e masave parandaluese, lehtësuese, mbrojtëse dhe rehabilituese në objektet infrastrukturore që përbënë një kërcënëm serioz për jetën e njerëzve, pronat e tyre dhe mjesin, të cilat ndikojnë në rikthimin e jetës normale për komunitetin dhe veprimtaritë e tij ekonomike;
- c) për shërbime të ndërhyrjes së menjëherëshme në shpëtimin e jetës së shtetasve, pronës private e publike, si dhe mbrojtjen e mjesit, të cilat janë dëmtuar ose kërcënohen nga fatkeqësi të ndryshme;
- ç) ngritjen, përditësimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave;
- d) për mirëmbajtjen dhe për funksionimin e sistemit të monitorimit, të paralajmërimit të hershëm të njoftimit dhe alarmit;
- dh) mbajtjen në gatishmëri të sistemeve të mbrojtjes nga zjarri, kalueshmërinë e pandërprerë të rrugëve rurale, vendet e strehimit, si dhe mbledhin dhe administrojnë rezervat ushqimore për njerëzit dhe gjënë e gjallë;
- e) mbajtjen në gatishmëri të infrastrukturës së ujites, të kullimit, të mbrojtjes nga përmbytja dhe digat e rezervuarëve në administrim të tyre;
- ë) për shpenzime të kryera për blerje karburanti dhe pjesë ndërrimi për automjete dhe makineri, të cilat përdoren për përballimin e situatave emergjente të krijuara si pasojë e një fatkeqësie;
- f) për mbulimin e shpenzimeve të tjera operative të kryera gjatë përballimit të ngjarjeve dhe situatave të emergjencës civile;
- g) për blerje materialesh të ndryshme, që i shërbejnë veprimtarisë së strukturave të emergjencës civile në nivel vendor;
- gj) për marrjen e masave mbrojtëse, parandaluese dhe për financimin e objekteve që ndikojnë në rikthimin e jetës normale për komunitetin dhe veprimtaritë e tij ekonomike;
- h) për likuidimin e detyrimeve fiskale, taksa portale dhe tatime, të shpenzimeve të transportit dhe akomodimit të forcave, mjeteve të specializuara të vendit dhe të huaja, të pajisjeve dhe makinerive të marra me qira dhe të dhuruara, si dhe për magazinimin e tyre.

4/2. Në rast se do lindë nevoja dhe do të taprojnë fonde nga pikë 4/1, fondi i dedikuar për mbrojtjen civile mund të përdoret deri në masën 30 % për:

- a) plotësimin e strukturave operacionale me pajisje dhe trajnime në fushën e mbrojtjes civile;
- b) për marrjen me qira të pajisjeve, mjesive private, mjeteve motorike, mjeteve ajrore dhe makinerive të ndryshme, si dhe për dëmin e shkaktuar nga ekzekutimi i punimeve në pasuritë e paluajtshme të shtetasve në përballimin e situatave emergjente të krijuar si pasojë e një fatkeqësie, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi;
- c) organizimin e fushatave të sensibilizimit dhe informimit të komunitetit në fushën e mbrojtjes civile dhe reagimit ndaj fatkeqësive natyrore ose fatkeqësive të tjera;
- ç) përditësimin e strategjisë, dokumentit të vlerësimit të riskut dhe planit të emergjencave civile për reduktimin e riskut nga fatkeqësitë, në nivel lokal dhe planet e evakuimit;
- d) mbështetjen financiare të operacioneve me forca dhe mjete të bashkive të tjera apo të huaja, në raste të fatkeqësive natyrore apo fatkeqësive të tjera,

4/3. Sipas rastit dhe në qoftë se do të teprojnë fonde nga pikat 4/1 dhe 4/2, fondi i dedikuar për mbrojtjen civile mund të përdoret deri në masën 10 % për:

- a) aktivizimin e kapaciteteve të subjekteve publike e private brenda territorit administrativ të tyre, për të bashkëpunuar dhe për të asistuar bashkitë fqinje, në rastet kur kjo e fundit është prekur nga një fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi tjetër;
- b) për veprimtari të ndryshme që organizojnë strukturat përgjegjëse të mbrojtjes civile, për aktivitetet, trajnimet dhe shërbimet që ndikojnë direkt në forcimin e këtyre strukturave;
- c) për botime, për veprimtari kërkimore-shkencore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile dhe aktivitete të tjera në interes të strukturave të mbrojtjes civile.

Në nenet 5, 6 dhe 7 është risqaruar edhe njëherë procedura që çdo akordim fonde nga bashkitë duhet të miratohet me vendim Këshilli Bashkiak dhe më prefekti i qarkut, pas shqyrtimit, sipas ligjit nr. 107/2016, lajmëron AKMC-në dhe MM-në për VKM-në e prioritazimit të buxhetit të destinuar për mbrojtjen civile. Edhe nevoja apo domosdoshmëria për të përdorur më shumë fonde në një nga pikat 4/1, 4/2 dhe 4/3 duhet të argumentohet nga bashkia dhe të miratohet me vendim Këshilli Bashkiak.

Në nenin 8, me kërkesë edhe të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, por duke parë edhe si të arsyeshme kontrollin e përdorimit të këtij foni, bashkitë, 1 herë në 4 muaj, duhet të raportojnë për përdorimin e fondeve, mënyrën e përdorimit të tyre te Ministria e Mbrojtjes, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe te Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, bashkitë dhe prefektët e qarqeve, për zbatimin e këtij vendimi.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Në zbatim të urdhrit të Kryeministrat nr. 148, datë 5.11.2020, është ngritur grupi ndërinstitucional i punës për përgatitjen e tij. Ky grup kryesohej nga drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë në fushën e mbrojtjes dhe në përbërje kishte përfaqësues nga institucionet, si më poshtë:

- Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore;
- Drejtoria për Çështjet Vendore dhe Prefekurat, në MB;
- Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë;
- Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore, në Ministrinë e Mbrojtjes;

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”.

- Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile.

Sekretar i grupit të punës ishte një përfaqësues i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.

Ky projektvendim është dërguar për mendim pranë Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Brendshme, Këshillit Konsultativ dhe Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Brendshme janë shprehur me komente dhe projektvendimi do të dërgohet për bashkërendim në këto ministri.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Efektet financiare të këtij projektvendimi do të përballohen nga buxheti i shtetit.

PROPOZUESI

MINISTRI I MBROJTJES

Niko Peleshi

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”.